

KKD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 124 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 / 08 / 2023

**VENDIM**

Nr. 32 date 30 / 08 / 2023

**PËR**

**PROJEKT IDENE E OBJEKTIT**

**“RIKONSTRUKSIONI I DIGES SE REZERVUARIT TE VRAPIT”, TIRANE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.08.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane për Rikonstruksionin e Diges se rezervuarit të Vrapit e cila administrohet nga kjo Bashki. Kjo dige me lartësi 19 m është ndërtuar në vitin 1973. Në dokumentacionin e paraqitur nuk jepet asnjë dokumentacion në lidhje me pronësinë dhe autoritetin e shfrytëzuesit të diges.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente Zenit&CO shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se **projekti nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit të mesiperm si dhe të nenit 8 të VKM se mesipërme**. Raportet mbështetëse për studimet sizmike, gjeologjike dhe gjeoteknike nuk janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 15.02.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mungojnë të dhënat për matjet batimetrike, sistemet e monitorimit të diges, vendi i karrierve për materialet e ndërtimit që do të përdoren, informacion në lidhje me njëzërit në rrezik poshtë diges, etj

Keshilli Teknik i Perhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të mos miratoj Projekt Idene e paraqitur për shkak të mungësive të paraqitura me sipër dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislativitetit në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratoj Projekt Idene për Rikonstruksionin e Diges se Rezervuarit Vrap për shkak të mosplotësimin të kërkesave të legjislativitetit në fuqi, mangësive të konstatuara në studimet mbështetëse për ceshtjet e Sizmikes, gjeologjise dhe gjeoteknikes si dhe mangësive në lidhje me sistemet e monitorimit, matjet batimetrike të rezervuarit dhe studimit për karrierat e parashikuara
- 2- Ti kërkoj Bashkisë Tirane
  - Të rishikoj studimet mbështetëse për Sizmiken, Gjeologjinë dhe Gjeoteknikën e zonës në përputhje me kushtet aktuale dhe udhëzimeve të KKDM të shprehura në Vendimin Nr. 15, datë 15.02.2021. Të kryejë matjet batimetrike dhe të paraqesë studimin përkatës për vendet e karrierve për materialet e ndërtimit dhe për njëzërit në rrezik duke u bazuar në llogaritjen e vales vërsuese dhe në hartat e përmblytjeve për zonat poshtë diges



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te parashikoj ne projekt idene e paraqitur sistemet e nevojshem te monitorimit te diges
- Te plotesoj dokumentacionin e projekt idese per rikonstruksionin e diges se rezervuarit te Vrapit ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi te permendura ne kete Vendim Nr. 35, date 12.10.2021 dhe pas shqyrtimit te dokumentacionit te zbatimit te ketyre punimeve, te qartesoj dhe te shprehet ne lidhje me domosdoshmerine dhe efektivitetin e nje projekti te ri per rikonstruksionin e kesaj dige.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

